

ENTI RREGULLATOR I UJIT
REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
2026

Nr.	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e kthimit të përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit	Tarifa
1	08.01.2026	1. Raportet e performancës së UKT për cilësinë e ujit të rrjetit të Tiranës për vitet 2020–2025. 2. Gjetjet e inspektimeve të kryera nga ERRU për Tiranën gjatë të njëjtës periudhë. 3. Informacion mbi masat administrative ose gjobat që janë marrë ndaj UKT për shkelje të parametrave të cilësisë së ujit. 4. Kopje të udhëzimeve, standardeve ose rregulloreve që UKT duhet të përmbushë për sigurimin e ujit të pijshëm. 5. Informacion mbi raportimin e detyrueshëm nga Bashkia dhe UKT mbi cilësinë e ujit dhe pasojat e shkeljes së standardeve.	20.01.2026	Pyetje nr. 1 - Raportet e performancës së UKT për cilësinë e ujit të rrjetit të Tiranës për vitet 2020–2025. <u>Përqijqje ERRU:</u> Në zbatim të gërmës (d), të nenit 5; gërmës (dh) dhe (h) të nenit 7 të ligjit nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”; pikës 2, të nenit 4 të VKM-së nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”” e ndryshuar, insitucioni përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik. Informacionet e kërkuara, të cilat lidhen vetëm me cilësinë e	Elektronikisht	Nuk ka

				ujërave të pijshëm, mund të merren dhe administrohen vetëm nga institucioni përgjegjës. Pyetje nr. 2 - Gjetjet e inspektimeve të kryera nga ERRU për Tiranën gjatë të njëjtës periudhë. <u>Përgjigje ERRU:</u> Nuk ka inspektime të realizuara gjatë kësaj periudhe. Ka vetëm një raport monitorimi, mbi monitorimin e ankesave I cili është për periudhën janar 2018 - qershor 2020, pra përfshin vetëm 6 mujorin e parë të vitit 2020. Raportin e gjeni bashkëlidhur. Pyetje nr. 3 - Informacion mbi masat administrative ose gjobat që janë marrë ndaj UKT për shkelje të parametrave të cilësisë së ujit. <u>Përgjigje ERRU:</u> Vlen përgjigjia e pyetjes nr. 1. Pyetje nr. 4 - Kopje të		
--	--	--	--	---	--	--

			udhëzimeve, standardeve ose rregulloreve që UKT duhet të përmbushë për sigurimin e ujit të pijshëm. <u>Përgjigje ERRU:</u> Aktet rregullatore janë si më poshtë: 1. Kushtet e licencës së miratuar nga KKRR, që i bashkëlidhen vendimit për licencim shoqërive UK së bashku me formatin e licencës. 2. Kodi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve i cili është i miratuar me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve sh.a” i cili është detyrim për të gjitha shoqëritë UK dhe tek pjesa e dytë e tij Sistemet e furnizimit me ujë, pika 2.11, faqja 26, Cilësia e ujit. Bashkëlidhur gjeni dokumentat e sipërpërmendur. Pyetje nr. 5 - Informacion mbi raportimin e detyrueshëm nga Bashkia dhe UKT mbi cilësinë		
--	--	--	--	--	--

				e ujit dhe pasojat e shkeljes së standardeve. <u>Përgjigje ERRU:</u> Vlen përgjigjia e pyetjes nr. 1.		
--	--	--	--	---	--	--